

URDHËR
Nr. 583, datë 1.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 213, DATË 19.11.2025, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR KUSHTET, KRITERET, AFATET, SI DHE
PROCEDURËN PËR KATEGORIZIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren “Për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese”, miratuar me urdhrin nr. 213, datë 19.11.2025, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 e nenit 6 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në portalin unik qeveritar “e-Albania” nga kërkuesi është:

a) Dokumenti që vërteton të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të ligjshëm të objektit ku ushtrohet veprimtaria, sipas njërit prej dokumenteve të mëposhtme:

i. certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë;

ii. leja e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit të objektit, të lëshuara nga organi kompetent;

iii. kontrata e qirasë, huapërdorimit ose një marrëveshje tjetër përdorimi me pronarin e objektit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të provojë të drejtën e përdorimit të ligjshëm të objektit për ushtrimin e veprimtarisë.”;

b) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 6 shtohet fjalia “Adresa e deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit duhet të përputhet me adresën e strukturës akomoduese për të cilën kërkohet kategorizimi”.

c) Pikat 1 dhe 2, të nenit 7, ndryshojnë si më poshtë:

“1. Pas depozitimit të kërkesës në portalin unik qeveritar “e-Albania”, Sekretaria Teknike kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi. Në rast se dokumentacioni rezulton i plotë, kërkesa i kalon për shqyrtim Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike, i cili brenda 10 ditëve nga data e konfirmimit të plotësimit të dokumentacionit shqyrton dhe vlerëson përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për kategorizimin e strukturës akomoduese.

2. Kur, gjatë verifikimit paraprak, konstatohen mangësi në dokumentacion, Sekretaria Teknike njofton kërkuesin, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, për plotësimin e tyre, duke i lënë një afat prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e njoftimit.”;

ç) Pika 5 e nenit 7 ndryshohet, si më poshtë:

“5. Afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk përfshin periudhën e nevojshme për plotësimin e mangësive të dokumentacionit nga kërkuesi. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara, Komisioni mund të zgjasë afatin e shqyrtimit jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, duke njoftuar kërkuesin nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

2. Në shtojcën nr. 3 “Kërkesë për t’u pajisur me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese” që i bashkëlidhet rregullores, teksti “Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës”, ndryshohet si më poshtë:

“Certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë ose leje ndërtimi me treguesit e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit të objektit lëshuar nga organi kompetent;

- Kontrata e qirasë ose e përdorimit me pronarin e objektit;

- *Planimetria e strukturës akomoduese;*
- *Foto aktuale të ambienteve të brendshme të pajisura dhe funksionale, dhe të jashtme të strukturës;*
- *Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri, për kategoritë “Dhomë”, “Apartament”, “Vilë” dhe “Bllok apartamentesh”, në rastet kur përmbushja e këtyre kërkesave vetëdeklarohet sipas kësaj rregulloreje;*
- *Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet higjiëno-sanitare, për kategoritë “Dhomë”, “Apartament”, “Vilë” dhe “Bllok apartamentesh”, në rastet kur përmbushja e këtyre kërkesave vetëdeklarohet sipas kësaj rregulloreje.”.*

3. Në të gjithë tekstin e rregullores, fjalët “aplikim”, “aplikues”, “aplikon” zëvendësohen me fjalët “kërkesë”, “kërkues” dhe “paraqet kërkesë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja